


Ç'eshtë epilepsia?



Schweizerische Epilepsie-Liga
Ligue Suisse contre l'Épilepsie
Lega Svizzera contro l'Epilessia
Swiss League Against Epilepsy

Info

Epilepsia



Çfarë janë krizat epileptike
dhe epilepsitë?

Epilepsia mund të prekë këdo

Masat e n Lidhja e epilepsisë Hulumton – ndihmon – informon

ÇFARË JANË KRIZAT EPILEPTIKE DHE EPILEPSITË?

Krizat epileptike janë çrregullime të trurit në bazë të shkarkimeve vazhdimisht në rritje të qelizave nervore. Epilepsitë janë kriza të përsëritura epileptike pa një arsye të dukshme për çastin e manifestimit.

Ekzistojnë më shumë se dhjetë forma të krizave epileptike dhe shumë më tepër forma të epilepsive, kjo edhe për faktin se ato mund të shfaqen në kombinacion me forma të ndryshme krizash. Sipas rregullit, secili individ i prekur ka vetëm një formë të epilepsisë me një deri në tri forma të krizës. Intervalet kohore midis krizave të veçanta mund të variojnë midis sekondave dhe viteve, madje edhe dekadave.

Fjala epilepsi rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë „të jesh i atakuar“, „të jesh i rrëmbyer“ ose „të jesh i kapluar ose i sulmuar prej diçkaje“. Deri në mesjetë epilepsitë i quanin, në mes tjerash, edhe „Morbus sacer“ ose „sëmundja e shenjtë“, duke i dhënë kështu një status të veçantë të cilin ndonjëherë ato e gëzojnë edhe sot e kësaj dite.

Format e krizës

Shumë individë besojnë se është shumë e thjeshtë që të përshkruhet një krizë epileptike: dikush papritur e pa kujtuar lëshon një klithmë, humbet vetëdijen, kafshon eventualisht gjuhën dhe shembet për dhe. Mban frymën dhe bëhet i zbehtë, pastaj shtangohet dhe për njëfarë kohe e zënë ngërçet në këmbë e në duar, derisa nga molisja të mos bjerë në një lloj gjumi të thellë. Pas kësaj, sipas rrethanave, ai do të ankohet për plogështi/apati, dhimbje koke, marramendje, pezmatim muskujsh, ndërsa ndonjëherë do të vijë edhe të ndonjë rrjedhje e pavullnetshme urine.

Ky përshkrim i përshtatet një forme të shpeshtë të krizave epileptike (të ashtuquajturës krizë „grand-mal“, ose krizë e përgjithshme tonikoklonike), mirëpo kjo formë krize është vetëm njëra nga të shumtat dhe jo më e shpeshta.

Krizat epileptike mund të kenë pamje shumë të llojllojshme. Ato mund të manifestohen pa klithje dhe alivani, pa shtangim, kafshim gjuhe ose rrëzim për dhe, pa zbehje dhe ngërçe. Ato mund të jenë aq të pafajshme e tinëzare sa as i prekuri vetë nuk kupton ndonjë gjë prej saj, as laikëve joprofesionalë të pranishëm nuk u bie në sy ndonjë gjë e pazakontë kur u bie të vëzhgojnë direkt një krizë të tillë. E

vetmja shenjë e një krize të tillë epileptike mund të jetë një humbje përqendrimi prej 5 deri 10 sekondash, ose një dridhje e shkurtër e njërit krah.

Një definicion i përgjithshëm

Një përshkrim me vlerë të përgjithshme dhe për të gjitha format e krizave epileptike mund të tingëllonte kështu: krizat epileptike janë ndryshime të befasishme, relativisht afatshkurtra të vetëdijes, procesit mendor, sjelljes, kujtesës, ndjeshmërisë dhe perceptimit ose tendosja e muskujve për shkak të një çrregullimi funksional të përkohshëm të qelizave nervore në tru, të cilat gjithnjë e më shumë dhe duke eskaluar shkarkohen elektrikisht mbi njëra-tjetrën. Ky definicion, ndonëse i vërtetë, është shumë i gjatë për ta mbajtur mend dhe për ta përdorur në jetën e përditshme. Për këtë shkak, krizat epileptike mund të definojnë në mënyrë të thjeshtësuar edhe si shfaqje të një çrregullimi të përkohshëm të qelizave nervore, me ç'rast efektet do të varen nga fakti se cilat detyra i ushtrojnë normalisht qelizat nervore pjesëmarrëse.

Shenjat e një krize epileptike

Secila qelizë nervore dhe secili bashkim qelizash nervore në tru mund të jetë „epileptik“, gjë e cila bën që ato të jenë të çrregulluara ose të penguara për të ushtruar aktivitetin e tyre normal. Nëse janë përgjegjëse qelizat për perceptimin e aromës, vjen deri te çrregullimi i nuhatjes; nëse do të ishin ato që janë përgjegjëse për shikimin, mund të vijë, për shembull, deri te perceptimi i shkrepimave ose ngacmimeve të tjera ndriçuese. Nëse ato janë aktiviste të kujtesës, kjo do të shprehet përmes një çrregullimi në mësim, ose eventualisht edhe në një ndërprerje vetëdijesh me një hapësirë boshe të qëndrueshme në memorie pas saj

Krizat dhe epilepsia

Shprehja „krizat epileptike“ është një emërtim i përbashkët që mund të përfshijë sëmundje krejtësisht të ndryshme. Te shumë njerëz, madje edhe me metodat që kemi sot në dispozicion, nuk gjenden shkaqe të prekshme për krizat e tyre. Jo çdo individ me një ose me më shumë kriza epileptike mund të ketë medoemos një epilepsi. Kështu, krizat epileptike mund të shfaqen pothuajse tek çdo njeri tek i cili, për shembull, është zhvilluar një qelbëzim i trurit (i ashtuquajturë absces i trurit), që ka pësuar një

lëndim të rëndë të kokës, truri i të cilit nuk është furnizuar mjaftueshëm me oksigjen, ose që ka marrë një mbidozë të medikamenteve të veçanta. Edhe pse në rastin e një persistence ose një përsëritjeje të këtyre rrethanave mund të vijë gjithashtu edhe te përsëritja e krizave, personat e prekur nuk kanë epilepsi.

Për një epilepsi do të flitet kryesisht pas më së paku dy krizash epileptike në një interval prej së paku 24 orësh, për të cilat nuk gjendet ndonjë shpjegim i dukshëm për çastin e manifestimit, që do të thotë se janë paraqitur spontanisht. Megjithatë shkakun përgjegjës për krizat mund të jetë brenda trurit, p.sh. ndonjë dëmtim gjatë lindjes, ose ndonjë lëndim tjetër i hershëm, i shumë kohëve më parë. Diagnoza e një epilepsie presupozon, madje, që shkaktari i një epilepsie vazhdon të ekzistojë midis krizave.

Çfarë nuk janë krizat epileptike dhe epilepsitë?

Në rastin e një sëmundjeje të vetme, përkundër sëmundjeve të tjera, njeriu mund të dijë shkakun e vërtetë vetëm për këtë formë të veçantë. Deri në këtë pikë pothuajse të gjitha epilepsitë nuk janë sëmundje, por më parë janë një grup sëmundjesh ose çrregullimesh për shkaqe të ndryshme, të cilat si tipar të përbashkët kanë shfaqjen e përsëritur të krizave epileptike. Mund të shpresohet, ndërkaq, se në një të ardhme të afërt do të kihet sukses që te një numër gjithnjë e më i madh epilepsish të zbulohen dhe sqarohen shkaqet e vërteta.

Gjithsesi një mjeku të mirë kryesisht i shkon për dore ta ekzaminojë, dhe mbi këtë bazë ta trajtojë, formën e pranishme të krizës dhe të epilepsisë.

POHIME TË GABUARA DHE TË VËRTETA PËR KRIZAT EPILEPTIKE DHE PËR EPILEPSITË

Gabim

Një krizë epileptike ka kuptimin e njëjtë me epilepsinë.

Krizat epileptike janë gjithmonë dramatike dhe nuk mund të mos vërehen.

Epilepsia është një sëmundje.

Epilepsia është një sëmundje me formë të njëjtë.

Epilepsitë është vështirë të trajtohen.

Epilepsia është një sëmundje psikike.

Epilepsia është e ndërlidhur me një paaftësi psikike.

Epilepsia është një sëmundje e trashëgueshme.

Të gjithë epileptikët janë pak a shumë të ngjashëm.

Drejt

Për një epilepsi do të flitet pas së paku dy krizash të paraqitura spontanisht pa ndonjë arsye të dukshme në çastin e manifestimit, në një interval kohor prej së paku 24 orësh, ose kur janë të mundshme kriza të tjera për shkaqe të tjera (p.sh. në rastin e një sindromi të epilepsisë).

Ekzistojnë kriza mezi të dukshme ose edhe me dukje të pafajshme epileptike.

Shumica e epilepsive në kuptimin e ngushtë nuk janë sëmundje, mirëpo pak a shumë sindroma uniforme shkaqesh të ndryshme; sëmundjet e epilepsisë me një shkak uniform (molekular-gjenetik) të njohur me saktësi janë të rralla.

Nuk ekziston vetëm një, por më shumë se 30 lloje të epilepsisë.

Rreth 60-70% të të gjitha epilepsive mund të trajtohen mirë me medikamente (mungesë e plotë krizash ose fare pak kriza, krahas një tolerance të mirë të medikamenteve).

Epilepsia është po aq pak një sëmundje psikike sa edhe sëmundjet tjera neurologjike.

Shumica dërrmuese e njerëzve me epilepsi nuk janë psikikisht të paaftë.

Më shumë se 90% e të gjitha epilepsive nuk janë të trashëgueshme, në kuptimin që në rastin e njërit prind të prekur të llogaritet me një epilepsi tek fëmijët.

Nuk ekzistojnë epileptikë tipikë ose uniformë; njerëzit me epilepsi dallojnë midis tyre si njerëzit me tension të lartë të gjakut ose me diabet.

Paragjykimet kanë një histori të gjatë

Megjithëse dekadave të fundit dijet shkencore mbi epilepsinë janë shtuar ndjeshëm, ajo i takon akoma edhe sot çrregullimeve shëndetësore, të cilat në opinionin publik ndeshin në një numër të madh paragjyimesh dhe përfytyrimesh të gabuara. Prandaj duhet bërë akoma një punë shumë e madhe sqaruese me publikun. Qysh edhe mjeku i njohur grek Hipokrati në kohën e tij (460-375 para Krishtit) kishte zbuluar se epilepsitë bazohen në një çrregullim në tru, mirëpo u desh të kalonin 19 shekuj derisa kjo bindje të refleктоhej edhe në trajtimet mjekësore – ndonëse me shumë ngurrim – gjithnjë e më shumë edhe në vetëdijen e përgjithshme.

Epilepsia mund të prekë këdo

Së paku pesë për qind e njerëzve gjatë jetës së tyre vuajnë nga një krizë epileptike. Afro një për qind e popullsisë sëmurët nga epilepsia gjatë jetës së tyre. Në Zvicër bëhet fjalë për 70.000 persona, midis tyre 15.000 fëmijë.

Lidhja e epilepsisë – shumëfish aktive

Lidhja zvicerane e epilepsisë hulumton, ndihmon dhe informon që nga viti 1931. Qëllimi i saj është përmirësimi i qëndrueshëm i përditshmërisë dhe gjendjes së të prekurve nga epilepsia në shoqërinë zvicerane.

Hulumtimi

Ajo nxit zhvillimin e mëtejshëm të shkencës në të gjitha fushat e epilepsisë.

Ndihma

Informacione dhe këshillime në gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht:

- për të prekurit dhe familjarët
- për specialistët e fushave nga më të ndryshmet

Informimi

Lidhja e epilepsisë informon dhe sensibilizon opinionin publik si dhe mbështet integrimin social të individëve të prekur nga epilepsia – si për shembull përmes kësaj broshure.

Prognozat e atëhershme të këqija të trajtimeve në gjysmën e dytë të shekullit 19 bënë që në shumë vende të Evropës për individët me epilepsi të ngriheshin institucione të veçanta si për më të varfrit e të varfërve. Në këtë mënyrë individët me epilepsi u vendosën afër të sëmurëve mendorë, që i kishte goditur një fat i ngjashëm. Pasi që deri në fillim të shekullit 20 u zhvilluan gjithnjë e më shumë mundësi trajtimi efektiv medikamentoz dhe kirurgjik, këto institucione për epileptikët u mbyllën ose u transformuan në klinika moderne neurologjike, përkatësisht, në qendra për epilepsi.

Përpiluesi:

Dr. med. Günter Krämer

Kryetar i Lidhjes së epilepsisë 2001–2016
izerischen Epilepsie-Liga

Fletëpalosje të tjera në gjuhën shqipe:

Ndihma e parë në krizat epileptike
Epilepsia dhe patentat e shoferit

Informacione të tjera

Në gjermanisht, frëngjisht, anglisht,
pjesërisht italisht:

Schweizerische Epilepsie Liga (Lidhja zvicerane e epilepsisë)

Seefeldstrasse 84

CH-8008 Zürich

T +41 43 488 67 77

F +41 43 488 67 78

info@epi.ch

www.epi.ch

PC 80-5415-8

Gjendja e informacioneve: 2017

Realizuar me ndihmën miqësore të sponsorit kryesor UCB-Pharma AG.



Inspired by patients.
Driven by science.

Sponsorë të tjerë: Desitin Pharma GmbH, Eisai Pharma AG, GlaxoSmith-Kline AG, Novartis Oncology, Sandoz Pharmaceuticals AG.

Sponsorët nuk kanë ndikim në përmbajtje.

Titelbild: ImagePoint/Markus Schneeberger